

1

PARTIA E PUNËS E SHQIPÉRISË
KOMITETI QENDROR

Tepëri Sekret

PLATFORMA
E PUNËS OPERATIVE
E ORGANeve TË
PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë, më 28.5.1977

PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISE
KOMITETI QENDROR

(12)

Tepër - Sekret

Nr. 00014

PLATFORMA
E PUNËS OPERATIVE
E ORGANeve TË
PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë, më 28.5.1977.

(18)

I

Organet e punëve të brendshme të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë janë një armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit që udhëhiqen nga Partia, për të dërmuar rezistencën e mbeturinave të klasave shfrytëzuese të përbysura, si dhe për të zbuluar planet, qëllimet e veprimtarinë e armiqve të jashtëm e të brendshëm; për të mbrojtur fitoret e revolucionit e Atdheun socialist, për triumfin e çështjes së komunizmit.

Organet e punëve të brendshme kanë për detyrë të ruajnë të paprekura kufijtë e Atdheut; të zbulojnë, parandalojnë dhe të godasin në kohë veprimtarinë armiqësore e keqbërëse; të sigurojnë jetën e udhëheqësave të Partisë e të Shtetit; të ruajnë ekonominë socialiste nga çdo veprimtari dëmtuese e keqbërëse; të sigurojnë rendin e qetësinë, të mbrojnë interesat dhe jetën e qytetarëve.

Në të gjithë veprimtarinë e tyre, organet e punëve të brendshme udhëhiqen nga vija e Partisë

(18) dhe mbështeten fuqimisht në popullin. Në punën e përditëshme dhe në politikën e goditjeve kundër elementëve armiq, ato udhëhiqen nga ligjëshmëria socialiste dhe vendimet e organeve të pushtetit popullor.

Udhëheqja e vazhdueshme e kontrolli i plotë, i gjithanshëm dhe i pandarë i Partisë mbi organet e punëve të brendshme, që është parimi themelor, mbi të cilin ndërtohet dhe udhëhiqet e gjithë veprimtaria e këtyre organeve, realizohen nëpërmjet drejtimit direkt të organizatave bazë, Komitetet e Byrove të Partisë në organe e reparte, të Komitetet e Partisë në rrethe, në reparte e njësi të ushtrisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë.

Ministri i Punëve të Brendshme jep llogari periodike në Byronë Politike dhe Këshillin e Ministrave mbi gjithë veprimtarinë e organeve të punëve të brendshme dhe merr prej tyre orientime mbi punën e këtyre organeve.

Organizata bazë dhe Komiteti i Partisë në organet e punëve të brendshme udhëheqin dhe kontrollojnë qendrimin dhe aktivitetin e të gjithë komunistëve e punonjësve të këtyre organeve. Ato

(20) shqyrtojnë çdo problem të punës së sektorëve të ndryshëm, me përjashtim të çështjeve që mund të sjellin dekonspirimin e agjenturës e të përpunimeve; përcaktojnë detyra e masa për forcimin e punës dhe aktivizimin e komunistëve e të gjithë punonjësve.

Për sekretarin e Komitetit ose të Byrosë të Partisë së organit të punëve të brendshme nuk ka asnjë kufizim konspiracioni të punës agjentalalo-operative.

Byrotë e Komitetet e Partisë të rretheve analizojnë punën e organeve të brendshme dhe bëjnë vlerësimin e veprimtarisë së këtyre organeve lidhur me zbatimin e vijës dhe direktivave të Partisë në zbulimin dhe shkatërrimin e veprimtarisë armiqësore e keqbërëse në rreth, mbi zbatimin e ligjëshmërisë, ruajtjen e ekonomisë socialiste, sigurimin e rendit e qetësisë, zbatimin e detyrave ndaj organeve të pushtetit në rreth, mbi sjelljet e marrëdhëni të punonjësve me popullin, etj.

Në këto analiza ruhet konspiracioni mbi çëshjet e agjenturës, përpunimeve dhe formave e metodave të punës operative.

Për sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrethit nuk ka asnjë kufizim konspiracioni të punës agjentalalo-operative të organeve të punëve të brendshme. Përgjegjësi i organeve të punëve të

(21) brendshme në rreth informon rregullisht sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrethit dhe, kur ky mungon për një kohë të gjatë, sekretarin që e zëvëndëson, për të gjitha problemet që i daliq degës të cilat duhet t'i dijë sekretari i parë i Komitetit të Partisë, qoftë për të orientuar punën e degës, ashtu edhe për të nxjerrë konkluzione e detyra për punën e Partisë në rreth.

Udhëheqja dhe kontrolli i Partisë në organet e sigurimit të ushtrisë, realizohet nëpërmjet këtyre formave:

Kuadrot e sigurimit të ushtrisë, për kryerjen e detyrave të tyre operative, nuk varen nga komanda e repartit dhe njësisë ku shërbejnë, por nga instancat më të larta të sigurimit, prej të cilave marrin urdhëra dhe udhëzime.

Çdo anëtar e kandidat partie, kuadër i organeve të sigurimit të ushtrisë, jep llogari para organizatës bazë të Partisë edhe për kryerjen e detyrave të tij funksionale, pa dekonspiruar agjenturën, përpunimet dhe metodat e punës operative. Organizata bazë bën karakteristikat e kuadrove të sigurimit të ushtrisë sa herë që del nevoja, ndërsa vlerësimi i plotë i punës së çdo kuadri bëhet nga sekretari i komitetit të Partisë dhe shefi i sigurimit të njësisë përkatëse.

Ministri i Mbrojtjes Popullore informohet për

(22) gjithë veprimtarinë armiqësore e keqbërëse që zhvillohet në shkallë ushtrije, pa asnje kufizim.

Zëvëndësit e Ministrit të Mbrojtjes Popullore informohen, sipas përkatësisë, për veprimtarinë armiqësore e keqbërëse që zhvillohet në shkallë ushtrije, pa dekonspiruar agjenturën, përpunimet dhe formatet e metodave e punës agjentalo-operative.

Shefi i sigurimit të korpusit ose njësisë së barabartë me të, informon sekretarin e Komitetit të Partisë të korpusit dhe, kur ky mungon për një kohë të gjatë, zëvëndësin e tij për veprimtarinë armiqësore e keqbërëse që zhvillohet në repartet e nënrepartet e njësisë së tij, për personat që zhvillojnë këtë veprimitari, si edhe për burimin e informacionit, kur kjo kërkohet.

Shefi i sigurimit të regjimentit dhe brigadës informon sekretarin e Komitetit ose të Byrosë të Partisë të regjimentit e të brigadës për veprimtarinë armiqësore e keqbërëse që zhvillohet në repartet dhe nënrepartet e njësisë, si dhe për personat që zhvillojnë këtë veprimitari, me përjashtim të rasteve kur përpunimi paraqet rëndësi të veçantë operative, kur personi që përpunohet është kuadër, shef shtabi batalioni e lart, si dhe kur personi në përpunim ka lidhje armiqësore jashtë repartit. Në këto raste, sekretari i Komitetit të Par-

(23)

tisë i regimentit ose brigadës vihet në dijeni mbasi të jenë marrë për këtë miratimi i sekretarit të Komitetit të Partisë së korpusit ose njesisë së barabartë me të dhe i shefit të sigurimit.

Sekretari i byrosë të batalionit dhe grupit autonom informohen mbi veprimtarinë armiqësore dhe keqbërëse në repart, pa treguar agjenturën dhe përpunimet.

III

Burimi kryesor i forcës së organeve të punëve të brendshme është populli. Patriotizmi dhe vigjilanca revolucionare e masave punonjëse duhet të përbëjnë bazën e informacionit dhe të luftës së organeve të punëve të brendshme për zbulimin dhe parandalimin në kohë të veprimtarisë armiqësore e keqbërëse.

Organet e punëve të brendshme duhet të forcojnë vazhdimisht lidhjet e tyre me popullin, të dëgjojnë zërin e masave, të mësojnë dhe të kërkojnë ndihmën e tyre për realizimin e detyrate të përditëshme.

Punonjësit e organeve të punëve të brendshme janë shërbëtorë të popullit. Veprimtaria e tyre duhet t'i nënshistrohet kontrollit të masave punonjëse.

(24)

Nën udhëheqjen e Partisë, organet e punëve të brendshme duhet të gjijnë vetë format dhe të krijojnë mundësi reale që masat punonjëse ta realizojnë këtë të drejtë, të kritikojnë të metat e dobësítë e mundëshme të këtyre organeve, si dhe sjelljet e qendrimet e papërshtatëshme të ndonjë punonjësi të punëve të brendshme. Të zbatohen me kujdes të veçantë orientimet e Partisë mbi kontrollin punëtor-fshatar e polic-ushtar në organet e punëve të brendshme dhe të forcohet dhënia llogari nga ana e tyre para masës e para organeve të zgjedhura të pushtetit popullor.

IV

Organet e punëve të brendshme për realizimin e detyrate të tyre kanë të drejtë të ndërtojnë punën agjentalo-operative kudo që e lyp nevoja, duke përjashtuar objektet e mëposhtëme:

- a. Organizatat dhe organet e Partisë;
- b. Komitetin Qendror të Rinisë, Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale, Këshillin Qendror të Bashkimit të Grave si dhe organet e tyre në rrethe;
- c. Aparatin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Gjykatën e Lartë;

(25)

ç. Aparatin e Kryeministrisë, Komisionin e Planiit të Shtetit dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme;
d. Organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

V

Për të zbuluar, goditur e parandaluar veprimtarinë e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe të elementeve keqbërës, organet e punëve të brendshme kanë të drejtë të ndërtojnë rrjetin agjentalur sekret të përbërë nga rezidentë, agjentë, informatorë dhe strehues.

Për krijimin e rrjetit agjentalur, në bazë të nevojave operative, këto organe përdorin në bashkëpunim sekret çdo qytetar të RPSSH ose shtetas të huaj.

Bashkëpunimi sekret me organet e punëve të brendshme bëhet mbi baza patriotike, vullnetare dhe mbi baza shterngimi kur në drejtim të kandidatit disponohen materiale kompromentuese që, sipas Kodit Penal të RPSSH, formojnë krim. Në këto raste, kur mendohet të aplikohet masa e arrestimit sekret, merret më parë sanksionimi nga Prokurori i Përgjithshëm i RPSSH.

Organet e punëve të brendshme kanë të drjetë

(26)

të përdorin në bashkëpunim sekret edhe anëtarë e kandidatë partie por kjo kategori bashkëpunëtorësh, në kuadrin e përgjithshëm të rrjetit agjentalur të këtyre organeve, duhet të jetë shumë e kufizuar. Pjesën kryesore të tyre duhet ta zenë rezidentët dhe strehuesit. Bashkëpunëtorë anëtarë e kandidatë partie, me cilësinë e agjentit, mund të ketë vetëm në raste të veçanta, kur puna operative ka rëndësi të posaçme.

Në çdo rast anëtarët ose kandidatët e Partisë që përdoren në bashkëpunim sekret të organeve të punëve të brendshme, duhet të mos kenë funksione partie dhe, para se të tërhiqen në bashkëpunim, duhet të merret miratimi i sekretarit të parë të Komitetit të Partisë së rrethit, ndërsa në ushtri i sekretarit të Komitetit të korpusit ose njesisë të barabartë me të.

Për bashkëpunëtorët anëtarë e kandidatë partie nuk merret dokument (deklaratë) bashkëpunimi.

Ndalohet kategorikisht që bashkëpunëtori anëtar apo kandidat partie t'i raportoje organeve të punëve të brendshme mbi çështjet që mëson e diskuton në organizatën bazë të Partisë.

Ndalohet kategorikisht futja e bashkëpunëtorëve në veprime agjentalalo-operative me detyra që janë në kundërshtim me moralin komunist; ndalohet kategorikisht gjithashtu takimi sekret vetëm

(27) nga një punonjës i organeve të punëve të brendshme me bashkëpunëtorë që janë femra, si dhe marrja në hetuesi, vetëm nga një punonjës i hetuesisë, e femrave si të pandehura ose kallzimtare.

VI

Organet e punëve të brendshme kanë të drejtë të venë në përpunim agjentalur çdo shtetas shqiptar ose të huaj që paraqet dyshime ose zhvillon veprimtari armiqësore dhe keqbërëse, duke iu përbajtur këtyre rregullave:

a. Ndalohet të vihen në përpunim agjentalur anëtarët dhe kandidatët e Komitetit Qendror të Partisë, anëtarët e Qeverisë dhe deputetët e Kuvendit Popullor;

b. Kuadrot e nomenklaturës së Byrosë Politike ose të Sekretariatit të Komitetit Qendror mund të vihen në përpunim vetëm me miratimin e Sekretariatit dhe të Byrosë Politike të KQ të PPSH.

c. Për një anëtar e kandidat partie, që vihet në përpunim, merret më parë miratimi i sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit, ndërsa në ushtri (për anëtarë e kandidatë partie dhe për officerë) miratimi i sekretarit të Komitetit të Partisë të korpusit apo të njësisë së barabartë me të.

(28) ç. Studimi i të dhënave e materialeve që shërbjnë si bazë për hapjen e përpunimit agjentalur të një anëtar apo kandidati partie duhet bërë mirë dhe me shumë kujdes, me masa të shpejta operative për të verifikuar e dokumentuar çështjen sa më shpejt, që përpunimi të mos zgjasë shumë kohë.

VII

Në tërësinë e masave operative, në drejtim të zbulimit, dokumentimit, goditjes dhe të parandalimit të veprimtarisë armiqësore e keqbërëse, organet e punëve të brendshme kanë të drejtë të përdorin edhe këto mjete e lloje të punës operative:

1. Të bëjnë kontrollin sekret të korrespondencës post-telegrafike, simbas këtyre rregullave:

Në korrespondencën e brendshme kontrollohet, kur shihet e nevojshme, korrespondenca që zhvillojnë personat në përpunim agjentalur, personat e arratisur, dënuar, internuar e dëbuar, si dhe çdo korrespondencë tjetër kur ka të dhëna për përbajtje kundërrevolucionare.

Ndalohet kategorikisht kontrolli i korrespondencës që nuk përfshihet në kategorinë e mësimpërme.

Kontrolli postar i korrespondencës së jashtme

bëhet i përgjithshëm. Ai përfshin kontrollin e të gjithë korrespondencës e të koline që qarkullohen nëpërmjet kanaleve postare e doganore të vendit tonë me shtetet e huaja (letrave, telegrameve, bisedave telefonike, pakove, kolipostave, shtypit e botimeve të ndryshme).

Përjashtohen nga kontrolli i korrespondencës së jashtme:

a. Anëtarët dhe kandidatët e Komitetit Qendror; anëtarët e Presidiumit të Kuvendit Popullor e të Qeverisë, deputetët e Kuvendit Popullor, Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë, sekretarët e parë të Komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve; sekretarët e Komiteteve të Partisë të korpusve, grupimeve operative dhe njësive të barabarta me to.

b. Personat e ftuar nga Partia dhe Qeveria në vendin tonë;

c. Përfaqësítë diplomatike, kulturore dhe tregtare të vendeve socialiste në pozita të marksi-zëm-leninizmit; shtetasit e këtyre vendeve që ndodhen në vendin tonë, si dhe shtypi e botimet që dërgohen nga këto vende;

c. Posta diplomatike.

Kontrolli i shtypit dhe i botimeve që vijnë në vendin tonë nga jashtë e anasjelltas duhet të bëhet sipas rregullave të caktuara nga Komiteti Qendror i Partisë.

Gjatë kontrollit të korrespondencës, organet e punëve të brendshme kanë të drejtë të ndalojnë e të konfiskojnë korrespondencën me përbajtje kundërrevolucionare ose të dyshimtë për një veprimtari të tillë.

Kontrolli i korrespondencës duhet të bëhet pa lënë gjurmë e pa penguar në asnjë mënyrë shërbimin postar.

2. Të përdorin survejimin në drejtim të personave që janë në përpunim ose që dyshohen për veprimtari kundërrevolucionare, sipas rregullave të caktuara.

3. Të përdorin teknikën operative në drejtim të personave që janë në përpunim ose që dyshohen për veprimtari kundërrevolucionare, gjithmonë simbas nomenklaturës së vëties në përpunim.

4. Të përdorin fondin sekret (të veçantë) në veprime e masa operative, sipas kritereve e rregullave të caktuara.

VIII

Shifra shtetërore përpilohet, riprodhohet dhe administrohet vetëm nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme ngarkohet me drejtimin e organeve të shërbimit shifrar

(31)

të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë si brenda ashtu dhe jashtë vendit, si dhe për ruajtjen e sekretit gjatë përdorimit të shifrës.

Për caktimin e kuadrove të organeve të shifrës të tregohet kujdes i veçantë. Në emërimin e shifrantëve, Ministria e Punëve të Brendshme jep pëlqimin e saj.

Organet e punëve të brendshme nuk kanë të drejtë të njihen me përbajtjen e teksteve të shifruara që nuk i përkasin sektorit të punës së tyre.

* * *

Detyrat e organeve të punëve të brendshme në konditat aktuale kanë për popullin, Atdheun e socializmin një rëndësi të madhe.

Krahas detyrave për zbulimin dhe goditjen në kohë, në thellësi e në mënyrë të gjithanëshme të çdo lloj veprimtarie armiqësore e keqbërëse, organet e punëve të brendshme duhet të bëjnë një punë të madhe edhe për parandalimin e krimeve, për shpëtimin e njerzve nga rruga e gabuar, në të cilën kanë rënë viktima të aktivitetit armiqësor e keqbërës, duke gjetur e përdorur për këtë qëllim forma e metoda të ndryshme pune.

(32)

Që të mund të realizojnë këto detyra, punonjësit e organeve të punëve të brendshme duhet të karakterizohen nga një moral i lartë komunist; të janë të thjeshtë e të palodhur, patriotë të zjarrtë, trima e të gatshëm për të sakrifikuar gjithçka për popullin, të dashur me të, të rreptë e të pamëshirshëm me armikun.

Punonjësit e organeve të punëve të brendshme duhet të paisen me një pregatitje të thellë ideologjike e politike e vigjilencë të lartë revolucionare. E gjithë puna e tyre duhet të përshkohet nga një partishmëri e thellë. Çdo çështje të punës së tyre ata duhet ta shikojnë gjithmonë në prizmin politik; të janë sa luftëtarë të ashpër me armikun, aqë edhe punëtorë politikë e agitatorë të flaktë me masat.

SEKRETARI I PARË I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA (d. v.)